

### FIBA përkrah FBK-në për vendimin e anulimit të garave

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu më 1 prill është kontaktuar nëpërmjet telefonit nga Sekretari i Përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis. Ky i fundit e ka kontaktuar Fetahun për të pyetur se si po e përballon FBK dhe Kosova situatën me pandeminë COVID-19, si dhe e ka pyetur për stafin e FBK-së, dhe për gjithë komunitetin e basketbollit në vendin tonë. Gjithashtu njeriu kryesor i basketbollit në botë i ka dhënë përkrahje të plotë numrit një të FBK-së për vendimin e marrë nga Bordi i FBK-së me rastin e anulimit të garave në Superligën e Kosovës dhe Superligën e Meshkujve, duke thënë se është vendim i duhur për situatën në të cilën ndodhemi. Fetahu e ka falënderuar Sekretarin e Përgjithshëm të FIBA-s për kujdesin e treguar dhe i ka premtuar se FBK do të bëjë më të mirën e saj për të tejkaluar këtë situatë të vështirë dhe se do të vazhdojë të konsultohet me FIBA-n për çdo gjë në të mirë të sportit tonë të zemrës.

### Nënshkruhet Memorandimi i Bashkëpunimit mes MKRS-së dhe FBK-së

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka nënshkruar më 7 prill pesë memorandume bashkëpunimi. Njëra ndër to ishte edhe me Federatën e Basketbollit të Kosovës. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ka nënshkruar memorandumin për përkrahje financiare. Ministrja Dumoshi pati theksuar se përkrahja e MKRS-së për Komitetin Olimpik dhe katër federatat ju mundëson atyre të kenë planifikim më të mirë të aktiviteteve dhe të realizojnë programin e tyre në mënyrë më të suksesshme.



## Bordi i FIBA Evropës anulon 16 Kampionate Evropiane të gjeneratave të reja

Bordi i FIBA Evropës më 8 prill ka marrë vendim që të anulojë 16 Kampionatet Evropiane të gjeneratave të reja që ishin planifikuar të mbahen në korrik dhe gusht të këtij viti, duke përfshirë këtu edhe FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C që ka qenë në program për datat 11-19 korrik 2020 në Prishtinë. Një vendim të tillë Bordi i FIBA Evropës ka qenë i detyruar ta marrë për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19 në të gjithë botën.

## Arrijnë donacionet nga FIBA, terreni 3x3 dhe topat e Mini-Basketbollit

Më 17 prill, kanë arritur dy donacionet e FIBA-s për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK). Bëhet fjalë për terrenin e lojës 3x3, semaforin 3x3, topat e Mini-Basketbollit dhe topat për vajza. Në mars të këtij viti FBK ishte informuar nga FIBA se kjo e fundit ka vendosur të dërgojë një donacion me pajisje sportive për lojën 3x3 dhe deri te ky donacion kishte ardhur pas takimit që Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku e kanë pasur në nëntor të vitit të kaluar në Gjenevë me Sekretarin e Përgjithshëm të FIBA-s, Andreas Zagklis. Ndërkaq një tjetër donacion që tashmë ka arritur në zyre të FBK-së janë topat e Mini-Basketbollit dhe topat për vajza. FIBA në fund të vitit pati vendosur ta shpërblejë FBK-në për punën e shkëlqyeshme që kjo e fundit e ka bërë gjatë vitit 2019 për zhvillimin e basketbollit ndër të rinj në vendin tonë.





## **FBK me Grup të Punës për hartimin e Planit Strategjik 2021-2025**

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 20 prill e ka formuar një Grup të Punës, i cili do të fillojë punën në hartimin e Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025. Grupi i Punës do të mbikëqyret nga kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ndërsa do të udhëhiqet nga Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku, kurse në Grupin e Punës janë përfshirë të gjitha grupet e interesit të FBK-së, derisa FIBA gjithashtu do të jetë pjesë e këtij procesi shumë të rëndësishëm për FBK-në. Grupi i Punës e ka filluar punën në muajin maj, kurse i gjithë procesi i planifikimit strategjik do të zgjasë deri në fund të vitit. Plani Strategjik i FBK-së 2021-2025 do të paraqitet në Kuvendin e ardhshëm Zgjedhor të FBK-së që është në program në fillim të vitit 2021.

## **FBK dhe SHTBK me Grup të Punës në përgatitjen e kriterëve për licencim**

Federata e Basketbollit të Kosovës dhe Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK) më 21 prill i kanë filluar përgatitjet për edicionin e ardhshëm. Në fakt Boardi i FBK-së e ka formuar një Grup të Punës, i cili ka punuar në dy dokumente shumë të rëndësishme. Bëhet fjalë për përgatitjen e kriterëve për licencim të trajnerëve për edicionin 2020/21 dhe kriterëve për licencim të klubeve/shkollave të basketbollit. Grupi i Punës pritet që draftet e para të këtyre dy dokumenteve t'ia dorëzojë FBK-së dhe më pas ato dokumente do të bëhen publike për konsultime në opinionin, si dhe krejt në fund pritet të miratohen nga Boardi i FBK-së si dokumente përfundimtare.

## **Dushku mori pjesë në Takimin e Dytë të FIBA Europe Youth Commission**

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku më 22 prill ka marrë pjesë në Takimin e Dytë të FIBA Europe Youth Commission (Komisionit të Rinjve). Në fakt ky takim ishte paraparë të mbahej në Munihi, por për shkak të pandemisë COVID-19 është anuluar ky udhëtim (si të gjitha të tjerat në Evropë dhe Botë), dhe në këtë mënyrë FIBA Europe e ka organizuar videokonferencën, ku pjesëmarrës ishin të gjithë anëtarët e këtij Komisioni, si dhe Presidenti i FIBA Evropës, Turgay Demirel dhe Drejtori Ekzekutiv i FIBA Europe, Kamil Novak. Ky Komision është njëri ndër më të rëndësishmit të FIBA Evropës dhe grumbullohet çdo tre muaj për të diskutuar për zhvillimin e basketbollit ndër gjenerata të reja, duke përfshirë këtu edhe projektet në zhvillim e sipër dhe ato të reja.

## Kryetari Fetahu mori pjesë në videokonferencën e organizuar nga FIBA Europe

Në mbledhjen e 29 prillit me Kryetarin e FIBA Europe, Turgay Demirel, Nënkryetarët Jean Pierre Siutat, Carmen Tocala dhe John Goncalves, Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu raportoi për situatën aktuale në basketbollin vendor, anulimin dhe suspendimin e garave, problemet aktuale dhe potenciale me të cilat do të përballen akterët në sferën e basketbollit, si dhe paraqiti idetë e tij lidhur me përkrahjen e mundshme nga organizata botërore e basketbollit gjatë fazës së rimëkëmbjes nga efekti i pandemisë së krijuar me COVID-19. Duke njoftuar krerët e FIBA Europe për tri procese të rëndësishme strategjike e strukturore në të cilat është duke u angazhuar FBK-ja për momentin - hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Basketbollit, krijimi i sistemit të edukimit dhe përcaktimi i kriterëve për licencimin e trajnerëve të basketbollit dhe përcaktimi i kriterëve për licencimin e shkollave të basketbollit në vendin tonë, Kryetari Fetahu kërkoi përkrahjen e FIBA Europe për këto procese.

## Lojtarët dhe trajnerët bëjnë thirrje për kujdes dhe ushtrime

Federata e Basketbollit e Kosovës ju ka qëndruar pranë lojtarëve dhe klubeve në kohën e pandemisë. Të shumtë kanë qënë trajnerët dhe lojtarët që kanë bërë thirrje për kujdes, por gjithashtu kanë bërë thirrje që të mos ndalen stërvitjet individuale, sepse janë shumë të rëndësishme për sportistët. Drejtori i Përfaqësueses së Kosovës, Granit Rugova, pastaj lojtarët/et Dardan Berisha, Erjon Kastrati, Gëzim Morina, Drilon Hajrizi, Samir Zekiqi, Edmond Azemi, Valon Bunjaku, Leondard Mekaj, Ujkan Karanezi, Leon Neziri, Denis Zenelaj, Dion Sheqiri, Bleron Istogu, Irma Konjusha, Astera Tuhina, Zërina Shatri, Dea Pushkolli dhe trajnerët Christos Marmarinos, Mark Rodiqi, Furkan Sagklik, Bekim Maxhuni, Dritëro Sefaja, Edin Kërveshi, Illmen Bajra, Fidan Shatri, Ilir Selmani, Arianit Morina, Laurant Ibrahimimi, Artan Mehmeti, Saranda Daci, Dak Turku ishin ndër ata që bënin thirrje për kujdes dhe të mos ndalen stërvitjet.



## Bordi i FBK-së miraton Udhëzuesin e Ri për Organizimin e Final 8 dhe Superkupës së Kosovës

Bordi i Federatës Basketbollit të Kosovës më 4 maj i ka miratuar dy dokumente shumë të rëndësishme. Bëhet fjalë për Udhëzuesin e Ri për Organizimin e Final 8 të Kupës së Kosovës dhe Udhëzuesin për Organizimin e Superkupës së Kosovës. Organizatorët e Final 8 Kupës së Kosovës dhe Superkupës së Kosovës duhet t'i përmbahen me përpikëri këtyre Udhëzuesve gjatë organizimit të këtyre eventeve. Të dyja dokumentet janë hartuar nga Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme e FBK-së, e cila i është përmbajtur kritereve për organizim të eventeve të FIBA-s dhe Rregullores së Garave të FBK-së. Dokumentet mund ti gjeni në faqen zyrtare të FBK-së (Legjislacioni-Dokumentet).

## Programi “Her World, Her Rules” vazhdon në shtëpi, FIBA lavdëron Kosovën

Federatat Kombëtare në të gjithë Evropën po gjejnë mënyra për të vazhduar t'i mbajnë vajzat aktive përmes basketbollit gjatë kohërave sfiduese për shkak të pandemisë Covid-19. Njëra ndër Federatat që ka qenë më aktive, ishte edhe Federata e Basketbollit të Kosovës, ku FIBA e ka përmendur si shembull për të mirë. “Kosova ka qenë aktive në dhënien e mesazhit të programit, me fushatën e tyre në rrjetet sociale. Lojtaret u mblodhën virtualisht për ta ndihmuar njëra-tjetrën larg fushës”, thuhet në përshkrimin e FIBA-s për Kosovën. Gjithashtu janë përmendur edhe shembuj nga Shqipëria, Lituania, Bjellorusia, Spanja dhe Serbia.





## Takimet, MKRS- Federata Sportive

Drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës kanë pasur disa takime me ministren për Kulturë, Rini dhe Sport, Vlora Dumoshi, ku kanë biseduar për fillimin e mundshëm të aktiviteteve sportive dhe masat që duhet të ndërmerren. FBK-ja nga fillimi ka zbatuar në përpikëri udhëzimet nga Institucionet e Kosovës, duke respektuar të gjitha masat për të mbrojtur shëndetin e sportistëve.

## FIBA asiston FBK-në me ekspert të jashtëm për hartimin e Planit Strategjik 2021-2025

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku më 16 maj kanë marrë pjesë në një takim të organizuar nga FIBA në formë të videokonferencës. Në këtë takim FIBA-n e kanë përfaqësuar Radmila Turner, përgjegjëse për Federatat Nacionale nga FIBA Europe, Florian Pasquet, përgjegjës për zhvillimin e Federatave Nacionale nga FIBA, Geoff Wilson, ekspert i jashtëm i angazhuar nga FIBA për asistencë Federatave anëtare të FIBA-s në hartimin e planeve strategjike/planeve operacionale dhe Jeongmi Gëak, zyrtare nga FIBA për Federatat Nacionale. Tema e takimit ka qenë asistenca që FIBA mund t'ia ofrojë FBK-së në hartimin e Planit Strategjik 2021-2025. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu e prezantoi para zyrtarëve të FIBA-s punën që FBK-ja e ka nisur së bashku me Grupin e Punës të emëruar nga Bordi, në të cilin janë përfshirë të gjitha palët e interesit të FBK-së.

## Anulohen garat në të gjitha kategoritë seniore për edicionin 2019/2020

Në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur më 19 maj 2020, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë COVID-19, në bazë të kompetencave të veta statutare, unanimisht ka marrë vendim që të anulohet garat në të gjitha kategoritë seniore për stinorin 2019/2020. Vendimet për ndërprerjen dhe anulimin e garave të në gjitha kategoritë seniore, përfshirë vendimin e datës 31 mars 2020 për anulimin e garave në Superligat e Kosovës në basketboll, janë marrë duke pasur në vëmendje dhe radhë të parë shëndetin e lojtarëve, trajnerëve, punëtorëve sportivë dhe të gjithë akterëve të përfshirë në organizimin e garave të basketbollit, si dhe karakteristikat e sportit tonë, zhvillimi i së cilit është i pamundur në kohë kur pandemia globale po vazhdon që të jetë e pranishme në Kosovë.



## **Përzgjedhësi i Kosovës ligjëron para gjyqtarëve të Kosovës**

Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos më 19 maj ka zhvilluar një ligjëratë për gjyqtarët e Kosovës në platformën Zoom. Takimi “online” është organizuar nga FIBA Instruktori Nacional i Gjyqtarëve, Faton Kurshumlija. Marmarinos ka thënë se ky takim është shumë i rëndësishëm, derisa ka diskutuar për pikat e rëndësishme në basketbollin modern rreth komunikimit gjyqtar-trajner. Përzgjedhësi i Kosovës ka folur para gjyqtarëve të Kosovës edhe për përvojën e tij në basketbollin modern. Një çështje që është diskutuar, është edhe ajo e menaxhimit të situatave të stresit, të trajnerëve, gjyqtarëve, lojtarëve dhe publikut. Pra, si të menaxhohet situata në këto raste.

## **FBK-ja i bashkohet kampanjës #FibaBAsket**

Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA) së fundi ka lansuar kampanjën #FibaBAsket, që ka për qëllim dhënien e mesazhit pozitiv në këtë kohë pandemie. Kampanjës i është bashkuar edhe Federata e Basketbollit e Kosovës me llogaritë e saj në rrjetet sociale, ku është shumë aktive. Për disa ditë janë publikuar tri video, duke ju bërë thirrje basketbollistëve/eve që të stërviten në shtëpi dhe të mos ndalen. Gjithashtu FBK-ja ka inkurajuar edhe klubet, trajnerët, lojtarët, tifozët të përgatisin video me #FibaBAsket për të dhënë mesazhe pozitive, kur vendi po përballet me pandeminë Covid-19. Llogaritë e FBK-së në rrjetet sociale janë shumë aktive, derisa së fundi janë përgëzuar edhe nga FIBA për kampanjën “Her World, Her Rules”.

## **Vendim i Bordit Ekzekutiv për Plasman**

Në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur më 19 maj 2020, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë COVID-19, në bazë të kompetencave të veta statutare të përcaktuara në nenin 21, unanimisht ka marrë vendimin lidhur me rezultatet dhe arritshmërinë në të gjitha kategoritë seniore për edicionin 2019/2020. Pas ndërprerjes, pezullimit dhe anulimit të garave të të gjitha kategorive seniore, Bordi i FBK-së ka vendosur që në asnjë kategori të mos shpallet kampioni dhe të mos akordojë tituj sportivë, por që renditja përfundimtare momentale në garat seniore të meshkujt të merret për bazë ekskluzivisht vetëm për përcaktimin e ngritjes apo rënies nga niveli i garimit, në bazë të Rregullores së Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Propozicioneve të Garave për edicionin 2019-2020.

## Fillon puna intensive në përgatitjet për jetësimin e ligës së përbashkët Kosovë-Shqipëri

Më 20 maj nëpërmjet një videokonference është mbajtur takimi i parë i ekipeve teknike të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit (FSHB), të cilat do të punojnë në përgatitjet e dokumenteve dhe akteve normative të ligës së përbashkët. Në këtë takim morën pjesë edhe Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe kryetari i FSHB-së, Avni Ponari. Ekipet teknike do të udhëhiqen nga Sekretarët e Përgjithshëm të të dyja Federatave, derisa i gjithë procesi i përgatitjes së dokumenteve do të përfundojë gjatë muajit qershor, kurse marrëveshja pritet të nënshkruhet gjatë muajit korrik ndërmjet të dyja Federatave për themelimin e ligës së përbashkët.



## FBK përgatit Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit

Federata e Basketbollit e Kosovës më 23 maj e ka përgatitur Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit për të ndihmuar komunitetin e basketbollit në të gjithë Kosovën për tu rikthyer në aktivitetet e strukturuar të basketbollit. FBK ka punuar veçanërisht duke iu bazuar rekomandimeve të autoriteteve në vendin tonë. Ndërkaq më 9 qershor e ka përditësuar Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit pas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë të datës 08.06.2020. Për Federatën e Basketbollit të Kosovës prioritet është shëndeti i të gjithë njerëzve që janë pjesë e komunitetit të basketbollit e më gjerë. Basketbolli konsiderohet si një ndër sportet me kontaktin më të madh dhe për këtë arsye, FBK ka propozuar një numër masash që do të lejojnë zhvillimin e sportit të sigurt, në rast se klubet vendosin të kthehen në stërvitje duke iu përmbajtur vendimeve dhe instruksioneve të institucioneve tona të datës 08.06.2020. Andaj pas vendimit të fundit të institucioneve përgjegjëse në vendin tonë dhe duke iu referuar vendimeve dhe instruksioneve të lartpërmendura të këtyre institucioneve, FBK bazuar në praktikën më të mirë të Federatave simotra ka propozuar udhëzimet për stërvitje basketbolli në një fushë basketbolli të mbyllur (palestër) dhe që lejohet brenda komunitetit lokal.




## Gjyqtaret nga Kosova, pjesë e projektit të ri të FIBA Europe për Gjyqtaret Nacionale të Talentuara

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 6 qershor i ka nominuar tri gjyqtare, Irma Konjusha, Anjesa Haziraj dhe Lorena Haxha për projektin e ri të FIBA Europe për Gjyqtaret Nacionale të Talentuara. Në fakt ka qenë FIBA Europe, më saktësisht Departamenti i Referëve/e të FIBA Europe ai që ka kërkuar nga Federatat Nacionale që t'i propozojnë gjyqtaret me potencial për projektin e ri për Gjyqtaret Nacionale të Talentuara, që do të fillojë nga mesi i muajit qershor.



## Dushku, anëtare e Bordit të Drejtorëve të KUSA

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku më 7 qershor është zgjedhur anëtare e Bordit të Drejtorëve të organizatës KUSA (Kosovo United States Alumni). Dushku është zgjedhur në mesin e 11 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KUSA me mandat 3 vjeçar, derisa për këto poste kanë konkurruar gjithsej 26 kandidatë. Dushku në vitin 2017 ka qëndruar për 6 javë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të programit të Departamentit të Shtetit Amerikan "Global Sports Mentoring Program" dhe në fund të këtij programi ajo e ka paraqitur një Plan të Veprimit për fuqizimin e femrës në sport, të cilin plan tani në bashkëpunim me FBK-në, FIBA-n, Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë dhe Departamentin e Shtetit Amerikan në Uashington është duke e implementuar me mjaft sukses.



## Kosova A do të grumbullohet në muajin gusht

Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll do të grumbullohet në pjesën e dytë të muajit gusht. Përgatitjet do të udhëhiqen nga përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, i cili do të shohë nga afër formën e basketbollistëve. “Grumbullimi do të jetë një javor, i ngjashëm me përgatitjet e muajit shkurt dhe nëntor, ku do të ketë stërvitje përgatitore fizike dhe taktike, si dhe do të shikohet mundësia e angazhimit të një ndeshje miqësore. Grumbullimi do të mbahet në Prishtinë”, është shprehur Granit Rugova për faqen zyrtare të FBK-së.



## Vendim i Bordit të FBK-së për anulimin e garave të grupmohave të reja

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë COVID-19, në bazë të kompetencave të veta statutare më 10 qershor 2020 ka marrë vendim që të anulojë garat në të gjitha grupmohat e reja për edicionin 2019/2020 dhe me këtë rast nuk do të shpallen kampionët e këtyre kompeticioneve. Vendimet për ndërprerjen dhe më pas anulimin e garave në të gjitha kategoritë, përfshirë këtu edhe vendimet e datës 31 mars dhe 19 maj 2020, janë marrë duke pasur në vëmendje dhe radhë të parë shëndetin e basketbollistëve/eve, trajnerëve, punëtorëve sportiv dhe të gjithë akterëve të përfshirë në organizimin e garave të basketbollit, si dhe karakteristikat e sportit tonë, zhvillimi i të cilit është i pamundur në kohë kur pandemia globale po vazhdon që të jetë e pranishme në Kosovë.

## Fetahu dhe Dushku në takim pune me FIBA-n dhe FIBA Europe

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku më 10 qershor kanë pasur takim (nëpërmjet videokonferencës) me përfaqësues të FIBA-s dhe FIBA Europe. Tema e takimit ka qenë procesi i asistimit të FIBA-s në hartimin e Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025. Në fakt në një takim tjetër të organizuar në mes të muajit maj ka qenë FIBA ajo që e ka zyrtarizuar asistencën për FBK-në në hartimin e planit strategjik të FBK-së, duke e prezantuar edhe ekspertin e jashtëm të angazhuar nga FIBA për të asistuar FBK-në. Ndërkaq në takimin me FIBA dhe FIBA Europe prezantuan ekipin e udhëhequr nga eksperti i jashtëm Geoff Wilson që do të asistojë FBK-në në këtë rrugëtim shumë të rëndësishëm për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë. Pas takimit kryetari i FBK-së, Fetahu është shprehur shumë i kënaqur me rrjedhën e takimit dhe me përkushtimin e FIBA-s për të asistuar FBK-në në këtë projekt shumë të rëndësishëm për komunitetin e basketbollit në vendin tonë.

## Marmarinos ligjëroi para trajnerëve të Kosovës

Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, më 14 qershor ka ligjëruar para trajnerëve të Kosovës, me anë të platformave online. Tema e ligjërimit ka qenë Sulmi tranzicional dhe Sulmi i Hershëm. Ai ka ligjëruar për rreth 50 minuta, derisa në këtë ligjërim kanë marrë pjesë më shumë se 25 trajnerë vendorë të Kosovës. Ligjërimi ka qenë shumë i mirëseardhur për trajnerët vendorë, të cilët kanë fituar përvojë nga përzgjedhësi i Kosovës, i cili më herët kishte ligjëruar edhe para gjyqtarëve të Kosovës, për raportin Gjyqtar-Trajner.



## **FIBA Europe vazhdon mbështetjen e FBK-së edhe për dy vitet e ardhshme në projektin për zhvillim të gjeneratave të reja**

Federata e Basketbollit e Kosovës për vitin e gjashtë radhazi është fituese e projektit të FIBA Europe për zhvillim të gjeneratave të reja të ashtuquajtur FIBA Europe Youth Development Fund. FIBA Europe së fundi e ka informuar FBK-në se e ka aprovuar aplikacionin e dorëzuar javë më parë nga FBK-ja në FIBA Europe. FBK do të vazhdojë projektin e përbashkët edhe në dy vitet e ardhshme (2020-2022) me katër Federatat tjera Nacionale: Turqisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe Maqedonisë së Veriut, derisa Federata Turke e Basketbollit do të vazhdojë të jetë udhëheqëse e këtij projekti. Në këtë projekt do të jenë të përfshirë djem e vajza të moshës 13 vjeç dhe trajnerë të rinj e të talentuar.



## Kryetari i FBK-së në videokonferencën e FIBA Europe-s tregon për gjendjen e basketbollit dhe planet për të ardhmen

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu më 17 qershor ka marrë pjesë në videokonferencën e dytë e organizuar nga FIBA Evropë. Në këtë takim ishin të pranishëm presidenti i FIBA Europës, Turgay Demirel, Sekretari i Përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis, tre zëvendës presidentët e FIBA Europe, Drejtori Ekzekutiv i FIBA Evropës, Kamil Novak dhe përfaqësues të Federatave tjera Nacionale të Evropës. Në këtë takim është diskutuar mbi gjendjen në vendet e ndryshme dhe masave të sigurisë dhe shëndetit, të cilat janë të zbatueshme për Federatat pjesëmarrëse. U inkurajua shfrytëzimi i platformës së FIBA-s për këmbim të informatave dhe zhvillimi i aktiviteteve jashtë sallave, në veçanti 3x3, në momentin e parë që kjo të lejohet nga autoritetet në Kosovë. Duke falënderuar FIBA-n dhe FIBA Europe për përkrahjen e madhe të dhënë në procesin e planifikimit strategjik, si procesi më madhor për basketbollin e Kosovës në vitet e fundit, Kryetari Fetahu njoftoi për të gjitha zhvillimet e fundit dhe planin e kthimit në terrene sportive, natyrisht në bazë të udhëzimeve të FIBA-s dhe autoriteteve vendore. Gjithashtu u theksuan proceset e përgatitjes për Ligën Mbarëkombëtare me Shqipërinë, punën e bërë bashkë me SHTBK-në për edukimin dhe licencimin e trajnereve, kampet e zhvillimit dhe avancimit të Gjyqtarëve dhe kampet për Përfaqësueset e Kosovës që janë planifikuar për muajin gusht jenë të përfshirë djem e vajza të moshës 13 vjeç dhe trajnerë të rinj e të talentuar.



**FIBA**  
**EUROPE**

We Are Basketball

## Bordi i FIBA Evropës vendos për datat e FIBA Kampionateve Evropiane të vitit 2021

Bordi i FIBA Evropës ka vendosur për datat e sakta të FIBA Kampionateve Evropiane të vitit 2021. Sipas vendimit të Bordit të FIBA Evropës të datës 7 Prill 2020 të gjithë organizatorët e vitit 2020 kanë të drejtë të organizojnë eventin edhe në 2021 nëse dëshirojnë dhe kanë mundësi ta bëjnë një gjë të tillë. Me këtë rast FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha shtetet organizatore të eventeve të vitit 2020 të informojnë FIBA-n më së largu më 21 Gusht 2020 nëse ata dëshirojnë apo nuk dëshirojnë të organizojnë të njëjtin event edhe më 2021. Duhet theksuar se Federata e Basketbollit e Kosovës ka qenë organizatore e FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C në Prishtinë prej 11 deri më 19 Korrik 2020, por në prill të këtij viti për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, FIBA Evropa i anuloi të gjitha eventet. Në vitin 2020 FBK i kishte paraqitur 5 Përfaqësuese për të garuar në FIBA Kampionate Evropiane: Kosova U16 Meshkujt, Kosova U18 Meshkujt, Kosova U20 Meshkujt, Kosova U16 Femrat dhe Kosova U20 Femrat. Përveç Kosova U16 Meshkujt që garon në Divizion C të gjitha të tjerat garojnë në Divizion B.



## Fetahu: Ferizaj, Gjakova dhe Istogu të gatshme për zhvillim dhe avancim të mëtutjeshëm të basketbollit me përkrahjen e FBK-së

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu e ka pasur agjendën e ngjeshur pasi në ditët e fundit ka zhvilluar takime të rëndësishme për zhvillimin dhe avancimin e basketbollit në qytete të ndryshme të Kosovës. Numri një i FBK-së është takuar me Kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjinin, pastaj me Kryetarin e Komunës së Istogut, Haki Rugova dhe me Kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliun. Kryetari Fetahu në këto takime ka qenë i shoqëruar nga anëtarë të Bordit të FBK-së dhe zyrtarë të lartë të FBK-së. “Ideja e këtyre takimeve dhe pikërisht në këto tri qytete ka qenë mbështetja e klubeve aktive nëpër këto qytete nga ana e FBK-së, por edhe atyre që pritet të riaktivizohen në ditët në vijim. Unë jam shumë i kënaqur me rrjedhën e këtyre tri takimeve, sepse është e rëndësishme së veçantë që të kemi mbështetjen direkte nga njerëzit kryesorë të këtyre komunave”, ka thënë Arben Fetahu, kryetar i FBK-së.



## Dushku: Momenti i duhur për krijimin e Përfaqësueses A të Femrave

Në vitin 2020 FBK i pati paraqitur për të garuar Përfaqësuesen U16 dhe U20-Femrat, por që për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, FIBA i ka anuluar të gjitha Kampionatet Evropiane të parapara të organizohen gjatë kësaj vere. Këtë vit ka qenë në program edhe organizimi i FIBA Kampionatit Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në Qipro, e që është shtyrë për vitin e ardhshëm, më saktësisht në datat 15-20 Qershor 2021. “Mendoj se është momenti i duhur për krijimin e Përfaqësueses A të Femrave. Pra, është një rast shumë i mirë që në vitin 2021 dhe 2022 për dy vite radhazi do të organizohet FIBA Kampionati Evropian për Shtetet e Vogla, pasi që dihet se kjo garë organizohet për çdo dy vite, por që për shkak të pandemisë sivjet është anuluar dhe tani do të organizohet për dy vite radhazi. Besoj se për gjeneratën e pasluftës do të ishte nder dhe krenari që ta përfaqësonin Kosovën A-Femrat në një garë zyrtare, por edhe për basketbollistët e reja e të talentuara, pra do të ishte një kombinim mjaft i mirë i dy gjeneratave”, ka thënë Dushku.



## Kujtohet Gazmend Sinani

Më 23 qershor janë bërë dy vjet nga vdekja e basketbollistit të njohur të Kosovës, Gazmend Sinani. Ai kishte humbur jetën në një aksident trafiku. Numri 15 është pensionuar te Kosova për nder të tij. Drejtuesit e FBK-së, Arben Fetahu kryetar dhe Granit Rugova drejtor i Përfaqësueseve kanë vendosur kurora me lule te varri i tij, duke nderuar Sinanin. Ai do të mbahet shembull, si një lojtar dhe person i shkëlqyer.

Always in our hearts







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# FALEMINDERIT

Federata e Basketbollit e Kosovës falënderon Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe të gjithë sponsorët që i qëndruan pranë në këto kohë të vështira.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo  
MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT



**TEB**  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

**ART**  
MOTION

**STOBI**  
**FLIPS**

**RUGOVE**



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA